Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-19613/18
Dt. 14.08.2018

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë

VENDIM
(për Leje Rrënimi)

Kjo Leje Rrënimi i lëshohet:			
Emri:	**N.T.SH."ARDI SHPED" Gjakovë.**		
Adresa:	**Rruga "Avdurrahim Buza" numër 28**		
Telefoni:	**045 602 200**	Emaili:	

Lloji ndërtimit që do rrënohet:	**Objekti i kategorisë së II-të, me destinim objekt afarist – administrativ**		
Adresa e vend rrënimit (ose përshkrimi i lokacionit):	**Rruga "Nëna Tereze – Bardhyl Qaushi" (ish objekti – zyret e ish ndërmarrjes "Agimi".**		
Zona Kadastrale:	**Gjakovë - Qytet**	Nr. i Parcelës Kadastrale: **675/2**	

Hartuesi i projektit për rrenim:	**"STUDIO 11" – Gjakovë.**		
Adresa:	**Rruga "Migjeni"**		
Email:	Studio11@yahoo.com	**Telefoni:**	**049 426 426**

Me këtë vendim, poseduesit I lejohet rrënimi I ndërtimit – objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt afarist – administrativ, i cili gjindet në rrugën "Nëna Tereze", në parcelën kadastrale me numër 675/2, ZK: Gjakovë-Qytet, meqenëse në këtë parcelë do të ndërtohet objekti i ri sipas lokacionit të datës 29.06.2018 dhe Kushteve Ndërtimore – Vendimi me numër 07/351/01-7984, të datës 27.06.2018, të lëshuara nga DUMM.

Poseduesi i Lejes Rrënimit obligohet:

- Të fillojë me rrënimin e ndërtimit e brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje rrënimi sipas Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim;
- Të njoftoj Organin Kompetent për fillimin e rrënimit te ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të rrënimit;
- Te siguroj vend rrënimin për mbrojtje dhe siguri te qytetareve dhe ndërtimeve përreth vend rrënimit;
- Deponoj mbeturinat rrënimit sipas planit te menaxhimit të mbeturinave;
- Të sigurojë dokumentet e mëposhtme ne vend rrënim:

  - një kopje të kësaj Leje Rrënimi;

  - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes se rrënimit dhe kontraktuesit nëse rrënimi ndërtimit kryhen nga një palë e tretë;

  - një kopje e të gjitha dokumenteve të rrënimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;

  - projekti i rrënimit të ndërtimit dhe organizimi i vend rrënimit në harmoni me Kodin e Ndërtimit ose rregulloret teknike në fuqi për mbrojtje dhe siguri te qytetareve dhe ndërtimeve përreth;

A r s y e t i m

Aplikuesi **N.T.SH."ARDI SHPED",** me seli në Gjakovë në rrugën "Avdurrahim Buza" nr.28, e përfaqësuar nga Ardian Kusari, përmes kërkesës së evidentuar me numër 07-350/01-19613/18, të datës 06.07.2018, parashtruar DUMM-së, parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes se Rrënimit, për rrënimin e objektit ekzistues të kategorisë së dytë me destinim objekt afarist – administrativ, i ndërtuar në ngastrën kadastrale me numër 675/2, ZK: Gjakovë – Qytet, në rrugën "Nëna Tereze", me qëllim të pregatitjes së terenit për ndërtim, meqenëse në këtë parcelë do të ndërtohet objekti i ri sipas lokacionit të datës 29.06.2018 dhe Kushteve Ndërtimore – Vendimi me numër 07/351/01-7984, të datës 27.06.2018, të lëshuara nga DUMM.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të tërësishëm të rrënimit, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për **lëshimin e Lejes së Rrënimit**, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Rrënimi bazohet në shqyrtimin e provave:

- **Kopjen e Planit të datës 26.03.2018 së bashku me Certifikatën e Pronës me numër 22.02.2018, të lëshuara nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.**
- **Planin e Situacionit të datës 29.06.2018, të lëshuar nga DUMM.**
- **Vendimin për Kushte ndërtimore, me numër 07-351/01-7894, dt.27.06.2018, të lëshuar nga DUMM.**
- **Projekti i rrënimit të ndërtimit- Elaboratin për rrënimin e objektit me investitor "Ardi Shped:**

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.
Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

- **Investitorit,**
- **Drejtorisë për Punë Inspektuese,**
- **Arkivit.**

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani, jur. i dipl.

D r e j t o r i


Arben Bakalli, jur. i dipl.

Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Prone

KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakove Qytet
Poseduesi: 1 /1 NTSH "Ardi Shped"- qirambajtje 99 vite

Shk. zvog. 1: 500



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m²	
675-2	-	-	Oborr	-	0	00	38	
			Shtepi - Ndertese		0	05	64	
			Gjithsejtë		0	06	02	


Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

VËRTETON:
Arber Jusufi

Gjakovë 26.03.2018

K.K. GJAKOVË
Z.k.Gjakove Qytet
Ngastra:675-2

PLAN SITUACIONI



LOKACIONI: **NTSH "Ardi Shped"**
Parcela: **675-2 Z.K. Gjakovë -qytet**
Etazhiteti: **B+P+2**
SIPË RFAQJA: **S = 513.40m²**

Gjendja kadastrale
Gjendja faktike

Gjakovë,
29.06.2018

Punoi: Durrije Berisha I.D.A.

24.03.2018
Takeometri pregize
Auto Cad 2004

P = 1 : 5 00

Punoi : "GEO-REJ" Gjakovë
DREJTORI